MARMOFIX
NATURA

Të dhënat teknike

Përshkrimi i produktit

MARMOFIX Tiefgrund TG-130: Astar akrilik i cilësisë më të lartë për përdorim të brendshëm dhe jashtëm.

- Nën shtresë e shkëlqyer për të gjitha llojet e ngjyrave të bazuara në ujë
- Aplikim i lehtë, depërtim i lartë dhe shkallë e lartë e mbulueshmërisë (shpërndarjes)
- Kapacitet të lartë lidhës dhe qëndrueshmëri
- Ngjitje të fortë dhe tharje të shpejtë
- Sipërfaqe të njëtrajtshme për shtresën e fundit

Përdorime të rekomanduara

MARMOFIX Tiefgrund TG-130 është e përshtatshme për sipërfaqe të reja si llaçe, beton, tulla ose mure të nivelizuara me stuko. Rekomandohet për sipërfaqe alkaline (bazike). Stabilizon dhe izolon shumicën e sipërfaqeve poroze që veçmë janë të lyera me gëlqere ose ngjyra të kualitetit të ulët dhe mundëson ngjitje më të mirë dhe nivelizim për ngjyrat disperzive.

TIEFGRUND
TG-130 PRIMER

...GARANTIERTE
QUALITÄT!

www.marmofix.ch

Marmofix DOOEL Chelopek, Brvenica
Address: 101 Str, No. 3, Chelopek, 1216
Tetovo, R. North Macedonia
Tel: +389 75 211 222

MARMOFIX
NATURA

Të dhënat teknike

TIEFGRUND
TG-130 PRIMER

Karakteristika teknike

Rrëshira	Kopolimer akrilik
Dendësia	1,02±0,02 gr/ml
Viskoziteti pas prodhimit **Viskoziteti gjatë ruajtjes**	Ford Cup 4 28±3sec 23 °C Ford Cup 4 28±3sec 23 °C
Harxhimi	Varësisht nga absorbimi, dhe tekstura e sipërfaqes harxhimi mesatar për dy shtresa është: 0.1–0.15 L/m^2
Tharja **Koha për riaplikim**	45±10 Minuta 1±½ Orë (Koha e tharjes dhe riaplikimit mund të zgjasë më tepër në temperatura të ulëta dhe lagështi të lartë relative.)
VOC (Komponime të avullueshme organike)	Vlera kufitare për këtë produkt i kategorisë A/g është 30g/l (2010). Produkti përmban max. 29g/l.

Përgaditja e substratit dhe instruksione për aplikim

- **Përgaditja e substratit**
  Substrati duhet të jetë i pastër, i thatë dhe të mos përmbajë material defektiv dhe të ngjitur dobët për sipërfaqen si për shembull pluhur, yndyrë, kripë, etj. Shtresa të vjetra që shkëputen lehtë duhet të largohen.
  Sipërfaqet me myshk dhe alga duhet të pastrohen/dezinfektohen para aplikimit të astarit.
- **Përgaditja dhe aplikimi**
  Metoda e aplikimit: Furçë, rul, spërkatje pa ajër
  Hollues: Ujë
  Hollimi: Deri 100% v/v
  MARMOFIX Tiefgrund TG-130 aplikohet në një shtresë duke lënë sasi të tillë të produktit të holluar që është e mjaftueshme për tu lidhur dhe për të depërtuar në thellësinë e sipërfaqes. Duhet të shmanget formim i një shtrese shkëlqyese.
  Aplikimi nuk duhet të bëhet në temperatura më të ulëta se +5°C dhe mbi +30°C. Gjatë dhe pas të gjitha aplikimeve, produktet duhet të mbrohen nga ndikimet atmosferike. Mjetet duhet të pastrohen me ujë menjëher pas përdorimit.

Përdorimi dhe ruajtja

Duhet të mbahet larg fëmijëve. Nuk nevojiten masa të veçanta gjatë punës me **MARMOFIX Tiefgrund TG-130**. Kur produkti aplikohet me spërkatje, përdorni doreza mbrojtëse, syze mbrojtëse, dhe maskë. Në rast kontakti me sytë ose lëkurën, lani me sasi të bollshme të ujit, dhe sipas nevojës kërkoni ndihmë mjekësore. Mbetjet e produktit duhet të hudhen sipas rregullave lokale. Nuk duhet të hudhet në kanalizime apo mjedis. Mbetja e thatë ose e ngurtësuar mund të hudhet si mbetje nga vendi i punëve ndërtimore ose si mbeturinë shtëpiake. **MARMOFIX Tiefgrund TG-130** duhet të ruhet në temperatura mes +5 °C dhe +25 °C si dhe larg dritës së diellit. Në kovat origjinale të pahapura nën kushtet e lartëpërmendura, **MARMOFIX Tiefgrund TG-130** mund të ruhet për 24 muaj.

Paketimi

Kanta 10 L; 5 L; shishe 1 L